

# KAMERA

Kamera digjitale është kamera që ruan fotografi/video në memorien digjitale. Kamera digjitale është e ngjashme me kamerë me bazë filmike tradicionale, por kur bëni foto/video, imazhi incizohet nga një sensor. Disa kamera digjitale kanë memorie të integruar, por shumica përdorin një kartë SD kartë.

Shumica e kamerave digjitale përfshijnë ekran të vogël LCD që shfaq imazhet e incizuara, gjë që e bën më të lehtë për të kapur foto/video sa më të mira.

Kamerat shpesh kanë mikrofonta të integruara, por ndonjëherë kanë mikrofonta të jashtëm për kualitet më të lartë të zërit.



---

# Puna me kamerë

## Disa principe të përdorimit të kamerës

### 3 principe për të realizuar fotografi të mira

#### 1. Ndiriçimi

Pamja fokusohet menjëherë në pjesën më të ndritshme të fotografisë. Kjo është arsyeja pse ju shihni reklama kaq shumë që kanë hapësirë të bardhë

#### 2. Fokusi

Pjesët e kthjellura të një fotografie natyrshëm tërheqin vëmendje më shumë në një fotografi. Qartësia e imazhit është e këndshme për syrin, si dhe për trurin. Në një fotografi me shumë objekte, objekti më i fokusuar është ai i cili do të konsiderohet si objekt relevant nga shikuesi.

#### 3. Organizimi i mirë i skenës

Një imazh/video që ka shumë rrëmujë të objekteve, dhe nuk shihet qartë çka është qëllimi i fotografisë është i pakëndshëm dhe i paqarte për syrin. Kur ka shumë zhurmë (përmbajtje) në një fotografi, sytë nuk kanë ku të përqendrohen.

## Këshilla të dobishme

#### 1. Mbajeni të thjeshtë incizimin

Zmadhimi, lëvizja e kamerës anash i bëjnë incizimet më të komplikuar dhe nuk janë të këndshme për shikuesit. Pra, nëse është e mundur, mos lëvizni asgjë gjatë një e incizimi.

#### 2. Përdorni një stol me tri këmbë

Kjo bën një ndryshim të mahnitshëm në produktin përfundimtar. Edhe nëse dikush mendon se janë të qëndrueshëm, incizimet do të jenë dukshëm të lëkundshme pa një trekëmbësh. Sidoqoftë, nëse doni të krijoni një ndjenjë të shqetësimit në një skicë, mund ta arrini këtë duke e mbajtur kamerën ose duke e zhvendosur pak nga njëra anë.

### 3. Rregulla e ndarjes së ekranit në 3 pjesë



Rregulla e ndarjes se fotos/videos ne 3 pjese horizontalisht dhe 3 pjese vertikalisht, është që të kemi një orientim ku janë vendet e mundshme që duhet vendosur objektet me interes të fotografisë sonë. Ne pikë prerjet e vijave horizontale dhe vertikale duhet te vendosen objektet kryesore te fotografisë/videos sonë.

Kjo rregull ka për qëllim evitimin e fotografive që kanë objektin kryesor në mes.

#### 4. Kufizojeni skenën

#### 5. Gjatësia

Ndërkohë që ju mund ta bëni fotografinë pak artistike duke xhiruar nga lart ose nga toka, kamera duhet të jetë më së shpeshti në nivelin e syrit të personit që filmohet.

## Bartja e të dhënave nga kamera në kompjuter

**Lidhja direkte** - Përdorni një USB kabllo - Meqë shumica e kamerave digjitale sot kanë lidhje USB, kjo është mënyra më e mirë për të realizuar bartjen e të dhënave. Por kjo mënyrë nuk është gjithmonë efektive sepse varet nga kombinimi i kamerës tuaj, kompjuterit dhe sistemit operativ

**Fikni kamerën** - Para se ta lidhni/shkëputni kamerën digjitale, është mirë ta fikni . Lidhni njërën anë të kabllos (Micro-USB) me aparatit.



1. Lidhni anën tjetër në portin USB të kompjuterit



2. Ndizni kamerën. Kamera juaj duhet të shfaqet si një disk tek **My Computer** (Zakonisht me emër të prodhuesit të kamerës)
3. Kopjoni/Lëvizni të dhënat nga disku i paraqitur në MyComputer si nga çdo folder në kompjuter - p.sh. Duke përdor Copy, Cut, dhe Paste.

## Lidhja përmes lexuesit të SD kartës



1. Largoni fizikisht SD kartën nga kamera



2. Vendosni SD kartën e kamerës tuaj në lexuesin e kartës USB.
3. Lidhni USB me kompjuter.
4. Hapni **My Computer**, dhe aty duhet të shfaqet si **“Removable Disk”**
5. Hapni diskun e ri, dhe pas kësaj do të shihni të gjitha foto/videot e realizuara me kamerë.


## Editimi i videove me Windows Movie Maker (WMM)

Shkarkimin i Windows Movie Maker mund ta bëni falas në: <http://windows.microsoft.com/en-US/windows-live/movie-maker-get-started>

### Fillimi i një projekti

Kur hapni WMM (Windows Movie Maker), automatikisht do të fillojë një projekt për ju. Para se të bëni ndonjë gjë, riemëroni projektin duke zgjedhur "Ruaj projektin si" (ang. "Save project as") nga menyuja kryesore dhe ruajeni në lokacionin që dëshironi (shembull: My Documents)

## Importimi i videos



Për të importuar video, kliko butonin “Shto videot dhe fotot” nën menynë kryesore.

Prej atje, gjeni videon tuaj në kompjuter. Nëse jeni duke importuar nga një kamerë, provoni të shfletoni në diskun e kamerës tuaj nën "Kompjuter" në shfletuesin e fajlave. Pastaj zgjidhni fajlin për ta importuar.

## Modifikimi i videos



Ne WMM - Zgjedh videon e importuar duke klikuar mbi të. Nëse dëshironi të rirenditni një pjese te videos atëherë ju mund të tërhiqni dhe lëshoni atë pjese te videos, mirëpo paraprakisht duhet te siguroheni qe ajo pjese është e ndarë/prerë.


Për të ndare/prere videon përdorni menynë e re, “Video Tools”, që shfaqet ne listën e tabave te WMM. Këtu do të shihni opsionet për të ndarë videon, për te shkruar ose ndryshuar shpejtësinë e një pjese te videos.

- **Vegla e ndarjes** (Split Tool) do të ndajë videon tuaj në dy pjesë në pikën ku qëndron kursori.
- **Fshirja e videos** bëhet duke e zgjedhur videon dhe duke klikuar butonin “Delete”




Mund të shtojmë efekte të tranzicionit në mes të videove duke e zgjedhur videon, pastaj duke e zgjedhur njërin prej animacioneve nga menyja. Kjo do të shtojë efektin e tranzicionit në fillim të klipit të zgjedhur.

## Shtimi i fotove



Për të shtuar fotot, mund të përdorim butonin “Shto videot dhe fotot”. Pas shtimit të fotos, nëse e zgjedhim foton në panel, mund ta shohim prap menynë “Video Tools”. Ne mund ta ndryshojmë kohëzgjatjen e paraqitjes se fotografisë e cila fillimisht është 7 sekonda.




## Përdorimi i tekstit

Mund të shtoni tekst në tre mënyra, nën menynë kryesore.


1. Titull
2. Caption
3. Credits - Për CREDITS lëvizëse të cilat vendosen automatikisht në fund

Sa herë që përzgjedhim një video/foto me tekst, na paraqitet menya e re “Text Tools” (shq. Mjetet e tekstit), të cilat na ofrojnë një grup të opsioneve për të animuar tekstin, për të ndryshuar fontin/madhësinë etj.

### Shtimi i Muzikës



Nëpërmjet butonit “Add Music” (shq. Shto muzikë) ne mund të shtojmë këngë ose tinguj të ndryshëm në videon tonë . Sapo të keni shtuar një klip muzikor, ajo shfaqet si një shirit i gjelbër nën videoklipet tuaja. Ju mund të tërhiqni këtë për të lëvizur përgjatë videove.



Pasi të keni shtuar muzikën, do të shfaqet menya “Music Tools” (shq. Veglat për muzikë) . Këtu, mund të ndryshojmë volumin e muzikës, efekte të zbehjës, ose të ndajmë këngën.

## Eksportimi i videos finale



Për të eksportuar videon tënde përfundimtare kliko butonin “Save movie” (shq. Ruaj filmin) nën menynë kryesor, dhe nëse nuk është zgjedhur automatikisht, nga drop-down menu zgjidhni For Computer.

## Disa teknika për ndërtimin e filmit

Krijimi i videove me teknikën Stop Motion

- [https://www.youtube.com/watch?v=4yG\\_k2Zlë7Y](https://www.youtube.com/watch?v=4yG_k2Zlë7Y)
- <https://www.youtube.com/watch?v=YQkC0Qs3aD0>
- <https://www.youtube.com/watch?v=ppedXZHhE0>
- <https://www.youtube.com/watch?v=MEglOulvgSY>
- <https://www.youtube.com/watch?v=XVRRK0RkCHg>

- 
- <https://www.youtube.com/watch?v=PtATU8hU8DI>

## Mirembajtja

1. Evitoni rërën dhe pluhurin - Të keni kujdes të shtuar kur pastroni kamerën nga pluhuri ose rëra, ashtu që mos ti shtyni brenda në kamerë.
2. Evitoni lëngjet - Mbani lëngjet larg nga kamera. Si çdo pajisje elektronike edhe kamera mund të dëmtohet nga uji dhe lagështia.
3. Mos e prekni thjerrëzën e kamerës dhe ekranin LCD me dorë. Pastroni me leckë nga mikrofibra çdo herë që vëreni njolla nga gishtërinjtë ose ndonjë njollë tjetër.
4. Mos e drejtoni thjerrëzën në ndriçim direkt nga dielli, kjo mund të dëmtojë sensorin e imazheve brenda kamerës, ose edhe të ndizet zjarri.
5. Kujdes nga temperatura. Edhe pse kamerat përgjithësisht janë të ndërtuara të përballojnë temperatura të ndryshme, shumica e kamerave duhet kujdesur që të mos lihen në temperatura të larta. Mos e leni kamerën brenda në makine gjatë verës ose temperaturave të larta, pasi që shumë lehtë mund të nxehet dhe mund të dëmtohet. Gjithashtu mos e leni kamerën në të ftoftë të madhë pasi që mund të dëmtohet LCD ekrani.
6. Ruani kamerën me kujdes. Gjithmonë ruani kamerën në vend të thatë dhe të freskët, si dhe larg ndriçimit direkt nga dielli.